



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së tetë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 19.09.2019,
duke filluar në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Komitetit, anëtarët e Komitetit: Agim Gashi, Jeta Rafuna, Eman Rrahmani, Fadil Gashi, Vala Peshku, Halim Halimi, Sami Boroci dhe Genc Sherifi.

Munguan: Blerand Stavileci dhe Egzon Azemi.

Të pranishëm ishin edhe: Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, Valbona Ahmeti - Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Fatos Dibra, përfaqësues i Zyrës ligjore, Dren Kukaj, drejtor i Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, Shpresa Shala, drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit, Mentor Zeka, përfaqësues nga OSCE-ja dhe Qëndrim Arifi, përfaqësues nga INPO-ja.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Agim Kuleta, kryesues.**

Para se të fillonin me diskutimet për pikat e rendit të ditës, Agim Gashi tha se çdo herë para fillimit të vitit të ri shkollor, policia ka raportuar në Kuvend lidhur me gjendjen e sigurisë në komunën e Prishtinës, nën një. Në dy, na mungon informata për përgatitjet dhe fillimin e vitit të ri shkollor. Vetëm brenda këtij muaji ka pasur disa çrregullime, siç janë: aferat për objektin e gjimnazit "Ahmet Gashi", po e quaj aferë figurativisht në kuptim çrregullimi, ka qenë helmimi i nxënësve të shkollës "Elena Gjika" dhe disa çështje të tjera për të cilat ne duhet të njoftohemi në Kuvend. Pastaj është proces i regjistrimit të nxënësve, a është rritur numri i nxënësve, a është zvogëluar, si janë akomodua nxënësit nëpër objekte shkollore, cilat janë problemet dhe sfidat e qeverisë komunale dhe të sillen në mbledhje të Kuvendit, pastaj në Kuvend të angazhohemi për t'i tejkaluar ato, por ajo mungon. Neve nuk na duhet informata në gjysmën e semestrit, kur duhet me raportua për fundin e semestrit të parë, kjo duhet të bëhet ose në fund të muajit gusht, ose në fillim të shtatorit, por keni kohë deri në mbledhjen e Kuvendit.

Agim Kuleta, kryesues, tha se sa i përket çështjes së policisë, ne vetëm mund të bëjmë ftesën dhe ata sa janë të gatshëm me ardhur me raportuar nuk e di, me rëndësi është që ne ua bëjmë ftesën edhe këtë pjesën tjetër e shikojmë.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua ky

REND I DITËS:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së shtatë të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Propozimvendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2020 dhe Kornizës afatmesme buxhetore për periudhën 2020-2022(KAB);
3. Propozimrregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për organizimin e punës në shkolla fillore të mesme të ulëta dhe të mesme të larta 01. nr. 031-142411, dt. 09.06.2016;
4. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Alban (Sulejman) Ramadanit;
5. Propozimvendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit nr. 01.463/01-0101088/19, dt. 03.05.2019, për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi private;
6. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim Ndërmarrjes Publike Banesore (NPB);
7. Propozimvendimi për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm për zonën "Mati 1", vazhdimi i rrugës "B" (Bahri Fazliu), pjesa jugore, 2019-2027;
8. Propozimvendimi për miratimin e Vendimit për lënien në dispozicion të projektdokumentit të Planit rregullues të hollësishëm për zonën e lagjes "Kalabria", pjesa e kolektorit;
9. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ngritjen e shtatores së senatorit amerikan Robert Doll;
10. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së shtatë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së shtatë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pika e dytë

Propozimvendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2020 dhe Kornizës afatmesme buxhetore për periudhën 2020-2022 (KAB).

Valbona Ahmeti - Makolli bëri prezantimin e buxhetit për vitin 2020, duke cekur se buxheti është propozuar dhe përgatitur pas dëgjimeve buxhetore të organizuara nga Komuna. Dëgjimet buxhetore të këtij viti në Komunën e Prishtinës dhe komunat tjera janë mbajt pak me vonesë, për arsye se qarkorja është vonuar në nivel qendror dhe nivel lokal, për shkak të komplikimit që ka pasur Ligji për pagat.

Buxheti i Komunës së Prishtinës për vitin 2020 është 91,582,408 euro. Kjo shumë është e ndarë në 5 kategori ekonomike: paga janë 34,802,117.00, mallra dhe shërbime 19,111,479.00, komunal 2,000,000.00, subvencione 3,780,900.00 dhe investime kapitale 31,885,008.00.

Krahasuar me vitin 2018, buxheti i Komunës së Prishtinës ka një rritje prej 3,845,679.00 euro dhe ajo kryesisht ka shënuar një rritje në kategorinë e pagave dhe mëditjeve për shkak të Ligjit të pagave, i miratuar në Kuvendin e Kosovës.

Një sqarim për zotërinë që kanë qenë në dëgjimet buxhetore që i ka organizuar Kuvendi, konkretisht kërkesat kanë qenë prej kolegëve asamblistë të LDK-së dhe mbetem borxh me i njoftua që për Kuvend ato kërkesat që i kanë paraqitur, shumica janë të përfshira në investime kapitale, te kodi ekonomik, ristrukturimi i rrugëve rurale është sipas kërkesës së zotëri Halimit, kryetari e ka nënshkruar, është 2 km, nga Keçekolla në Nishevc, që ka qenë e cekur, edhe për mirëmbajtje i kemi marrë shënimet, ekziston ekstrakti, dhe për Kuvend ju sjellim të dhënat se është miratuar.

Agim Gashi tha se e dëgjova një konstatim se ka rritje krahasim me vitin e kaluar 2018, tek te hyrat vetanake.

Valbona Ahmeti - Makolli sqaroi se jo te të hyrat vetanake, përkundrazi, kemi zbritje te të hyrat vetanake jo vetëm Komuna e Prishtinës, por të gjitha komunat. Arsyeja pse është më i ulët buxheti, planifikimi i realizimit të të hyrave, sepse me kërkesën e Ministrisë së Financave me gjetjen, një gjetje që e ka bërë auditori i jashtëm, të hyrat prej gjykatës dhe policisë më nuk kanë të drejtë të llogariten në buxhetin e Komunës.

Agim Gashi tha se Ministria nuk e di a i ka kalkuluar mirë, por Komuna e Prishtinës ka kapacitete tjera për rritjen e të hyrave në sferat tjera.

Buxheti për vitin e ardhshëm a është planifikuar më i ulët sesa këtë vit, arsyen e dha drejtoresha dhe ne nuk kemi fuqi me ndryshuar. Mendoj se buxheti ka pasur mundësi të rritet.

Te shpërndarja e buxhetit, mendoj që nuk është menduar mirë në buxhetin në arsim, bujqësi dhe infrastrukturë.



Në dëgjim buxhetor e kam bërë një pyetje për 800 mijë euro që të planifikuar, ku thotë se shkolla e muzikës "Dua Lipa" në Pallatin e Rinisë, çka nënkupton kjo, a është fjala për shkollën "Prenk Jakova"?

Valbona Ahmeti- Makolli dha përgjigje, duke thënë se me renovimin e Pallatit të Rinisë, Shkolla e Muzikës do të kalojë në Pallatin e Rinisë.

Vala Peshku tha se është projekti i Gjakovës, që Dua Lipa ka me u bërë bashkë me shkollën "Prenk Jakova", është projekt i veçantë.

Agim Gashi tha nëse mendohet parimisht, po them me u transferuar objekti i shkollës së muzikës në objektin e Pallatit të Rinisë, është koncept total i gabueshëm, sepse Komuna e Prishtinës e ka një traditë edhe në fushën e kulturës dhe muzikës.

Unë kam propozuar që nga buxheti i Komunës të planifikohet ndërtimi i një shkolle fillore, ishte planifikuar i shkollës "7 Shtatori", në rregull, por edhe një shkollë fillore tjetër, sepse ka buxhet. Kamë kërkuar të fillohet me investime në kolektor, nuk e pashë, ndoshta për Kuvend e sillni, po ashtu projekti i zgjerimit të kanalizimit në Grashticë, Mramor, Slivovë, e fshatrave të tjera ku ujë ka të mjaftueshëm, e ata banorë i furnizon Njësia e zjarrfikësëve me cisterna çdo ditë, ne do ta ngremë edhe në Kuvend, se kur të fillon investimi, zgjerimi i rrjetit, me i mbuluar të gjitha ato vendbanime.

Valbona Ahmeti - Makolli dha përgjigje, duke thënë se te të hyrat vetanake nuk mundemi me i rritur, sepse tavanin e cakton Ministria e Financave. Sa i përket bujqësisë, vetëm investime i ka 750 mijë, mirëpo i ka edhe 750 mijë subvencione, që i bie total 1 milion e 500 mijë. Pak janë, por aq kemi pasur mundësi.

Eman Rrahmani bëri vërejtje rreth ftesës që u është dërguar për të marrë pjesë në diskutimet publike me qytetarë. Mua si përfaqësues i Kuvendit, materiali më është dërguar një ditë para datës së mbledhjes, dhe atë pas orës 15:00, kështu që nuk ka pasur asnjë mundësi që ne me marrë pjesë dhe me diskutuar se nuk kemi pasur asnjë material, që me ditur se çka do të iu afrohet atyre dhe cilat janë vijat buxhetore.

Te Korniza afatmesme, sikurse edhe vitin e kaluar, është vetëm përshkrim dhe nuk ka ndonjë strategji që mundemi, nuk e di sa është e drejtë, por miratimin e buxhetit e kisha ndarë me Kornizën afatmesme, ku Kornizën afatmesme e kisha qitur pikë të veçantë dhe Zyra ligjore është mirë që të punojë në të gjatë, që ta kemi një kornizë, e cila me të vërtetë i nevojitet Prishtinës e jo vetëm sa për ta miratuar e kaluar.

Valbona Ahmeti - Makolli dha përgjigje sa i përket materialit që nuk është dërguar me kohë, ai ka qenë dëgjim buxhetor, me i dhënë propozimet anëtarët e KPF-së, nuk ka qenë me diskutuar për këto çka i kemi bërë. E kemi dërguar me kërkesën e disa anëtarëve vetëm si material që e kanë kërkuar.

Sa i përket Kornizës afatmesme buxhetore, ndoshta nuk është ajo që është perfekt, por jemi munduar me bërë më të mirën. Vitin e kaluar ka qenë ankesa që me i ndarë ato që janë 1-vjeçare dhe cilat janë 3-vjeçare, kemi provuar, por jeni të mirëseardhur nëse dikush dëshiron me na

ndihmuar në anën profesionale ligjore, se edhe ju jeni pjesë e Komunës sikurse unë. Kam ftuar edhe anëtarë të USAID-it edhe me ta jam këshilluar, mundem me ta dërguar procesverbalin, për të parë se çka më kanë këshilluar ata.

Eman Rrahmani tha se diskutimet publike me qytetarë duhet me u bërë prej Kuvendit komunal dhe është obligim ligjor, por obligim i juaj është me na dhënë informacionin se si ka me u orientuar buxheti, sepse ne si asamblistë nuk mund të dimë se sa mjete janë ndarë për një fushë e sa për një tjetër, e kur të dalim në dëgjim publik me ditur çka është e pranueshme dhe çka nuk është e pranueshme edhe prej kërkesave të qytetarëve, sepse buxheti planifikohet në bazë të tavanit.

Agim Kuleta, kryesues, theksoi se ideja ka qenë kjo, Kuvendi duhet me mbajtur diskutimin publik, e ka mbajtur ekzekutivi, duhet me mbajtur edhe Kuvendi, kështu që anëtarët e Kuvendit në njëfarë mënyre me pasur edhe këta kontaktin direkt me qytetarët. Për këtë e kemi thirrur KPF-në, ku janë të gjithë përfaqësuesit e GP-ve dhe ideja është me i dëgjuar ne qytetarët e jo ne me diskutuar, sepse janë forumet, është KPF, mbledhja e Kuvendit ku ne diskutojmë. Nuk ka pasur nevojë fare ne me diskutuar aty, por vetëm qytetarët.

Agim Gashi propozoi një korrekturë të vogël te Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, faqe 30, te misioni i saj, ku thuhet: Është bartëse e procedurave të hartimit të Planit zhvillimor komunal, - këtu të shtohet "Hartës zonale dhe planeve rregulluese urbane".

Te faqja 13, Parashikimi i të hyrave buxhetore komunale 2020-2022, nga shtylla buxhetore 1-22, vetëm në katra ka njëfarë shkalle rritjeje apo uljeje prej vitit në vit, jo harmonike, sa ka në vitin 2020 ka edhe 2022! Unë nuk po kuptoj si është e mundur, thotë: Taksa për leje ndërtimi 6,500,000.00, si në vitin 2020 njëjtë në vitin 2021 dhe 2022, ndoshta ndryshon pak. Kur shifrat janë të ndryshme, të lenë përshtypje se janë bërë hulumtime. Unë e kam thënë se kjo është një shpërndarje e dobët e planifikimit, andaj është mirë me u përcjellë edhe nga drejtoritë përkatëse që reflektojnë në këto gjëra, të ulen ata zyrtarë që janë, se pak a shumë i dinë nga praktika problemet që i kanë, se a rriten apo zvogëlohen dhe sa për qind ndryshohen. Nuk mundet me qenë për tri vite planifikimi saktësisht i njëjtë edhe me cent. Pra, të jetë dokumenti më serioz.

Vala Peshku tha se kjo është Kornizë afatmesme buxhetore, e dinë çka dhe si ka me rrjedh 2020 dhe bazuar në 2020-ën bëhen edhe vitet tjera. Nëse thuhet se duam të kemi numra të ndryshëm prej viti në vite, veç me treguar kinse jemi më serioz, kjo është fjali që nuk i përket aspak këtij vendi as kësaj komune.

Agim Kuleta, kryesues, tha se rekomandimet u dhanë, andaj mbetet që drejtoresha t'i ketë parasysh se çfarë mund të bëhet.

Valbona Ahmeti Makolli u shpreh se në lejet e ndërtimit kemi mundur me bërë lëshim, se është hera e parë te kjo, te taksat, tash kur ka hyrë në fuqi Ligji nuk e kemi paraparë, por e kemi parasysh për Kuvend.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2020 dhe Kornizës afatmesme buxhetore për periudhën 2020-2022 (KAB), dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e tretë

Propozimrregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për organizimin e punës në shkollat fillore të mesme të ulëta dhe të mesme të larta, 01. nr. 031-142411, dt. 09.06.2016.

Osman Bllaca dha sqarime, duke thënë se kjo rregullore do të ndryshohet, ku do të shtohen vetëm dy nene, kjo ka ardhur si kërkesë, bashkërisht me drejtoreshën e Drejtorisë së Arsimit e kemi bërë. Unë jam kryetar i Komisionit disiplinor dhe kemi shumë raste të mësimdhënësve që janë me sëmundje të llojllojshme, sidomos sëmundje kancerogjene, dhe jemi në një situatë që nuk po dimë se si të veprojmë. Ne kemi folur me QMF-të dhe me Ministrin e Mirëqenies Sociale, vizionet e komisioneve mjekësore që ishin aty, dhe ata na kanë thënë se nuk ka zgjidhje tjetër, vetëm me përjashtim, duhet me i larguar nga puna dhe me i bërë persona me nevoja të veçanta, ku pastaj iu takon një kompensim prej 75 €, e tash kur po është sëmurë edhe shpenzime shumë më të mëdha e të ndalin prej 500 € e t'i marrin 75 €, për neve është me të vërtetë shumë vështirë. Ne i kemi lënë disa raste pezull, derisa ta marrim një vendim. Ne kemi diskutuar me Ministrinë e Mirëqenies Sociale, kemi pasur takim me ato komisione dhe ne jemi për me i dërguar në pension të parakohshëm me 70% të pagës. Te ne në nivel të përgjithshëm komunal janë më se 30 raste, e raste të rënda janë 20. Kategoria buxhetore na lejon, është prej sektorit të pagave, ne për këtë vite kemi pasur bartje, e kemi analizuar, 864 mijë euro i kemi bërë bartje, që nuk janë shpenzuar prej 2018-ës prej sektorit të pagave që e mbulon atë. Ndoshta është mirë edhe konkurs me hapur, ose me pasur një pagë që e merr më të vogël sesa që e merr mësimdhënësi i cili e zëvendëson atë, ose edhe këto punonjëset e kopshteve dhe shpallet konkursi me 200 € pagë, ajo paga që i takon derisa ky personi ta kryejë pensionin e parakohshëm, i cili e ka moshën 62, 63, 64-vjeç, një vit, dy, tri vite e mandej e merr pagën e plotë.

Agim Gashi tha se ajo pjesa tjetër rregullohet me ligjet tjera, por te dokumenti Propozimi për ndryshimin e Rregullores, jeni thirrur në nenin 67, e neni 67 shqipton masat disiplinore, e shkuarja në pensionin e parakohshëm nuk është masë disiplinore, te kuptimi, neni 67 i referohet të gjitha masave disiplinore për shkak të mos disiplinës, mos seriozitetit në punë, ndërsa shkuarja në pension është rezultat i gjendjes së keqe shëndetësore. Unë mendoj se ky nen nuk është i qëlluar, andaj duhet me ia gjetur vendin, me krijuar një nen të ri ose te nenet tjera.

Fatos Dibra dha sqarime, duke thënë se propozimi kur ka ardhur prej tyre, ka qenë për shkak se në udhëzimin juridik, që thotë se masë disiplinore e shërbimit civil është edhe nëse dikush shkon në komision disiplinor dhe e ka moshën 63 vjet, ka të drejtë si masë disiplinore komisioni disiplinor me qitë në pension të parakohshëm, pra kanë qenë dy raste edhe me vetë dëshirë, edhe si masë disiplinore, propozimet kanë ardhur kështu.

Agim Gashi theksoi se gjërat nuk paragjykohe, s'mundesh me paragjykuar se ai s'ka me pranuar se gjendja shëndetësore e detyron, se ai më shumë shpenzon kur punon sesa i humb 30% të pagës. Përmbajtja e kësaj duhet me qenë humane, nuk mundemi ne me prodhuan dokumente jo humane.

Halim Halimi tha se kjo është një punë shumë e mirë, se edhe ne që jemi marrë me këto çështje në arsim, e dimë që një pjesë e madhe e arsimtarëve shkojnë në shkollë me vështirësi nga sëmundjet e shumta, siç e tha Osmani, kancerogjene, ata shkojnë se duhet me jetuar dhe me marrë pagë, dhe kemi menduar që ata arsimtarë mos me shkuar, se nëse shkojnë në atë gjendje, nëse Zyra ligjore konstaton se ka bazë ligjore dhe mund të realizohet në praktikë, kjo është shumë e mirëseardhur. Atë që e tha Agimi, neni 67.11, shqiptim i masës disiplinore në pensionim të parakohshëm, kjo mund të keqpërdoret, sepse të moshës 60 vjeç, ashtu të lodhur, të sëmurë, mund të keqpërdoret nëse ata vetë nuk e paraqesin vullnetin e tyre për të shkuar.

Nenin 67.11, pensionim të parakohshëm nga mosha 60 vjeç me 70% të pagës bazë e kisha hequr, jo masë disiplinore me i shqiptuar, sepse tingëllon keq, njerëz të moshuar, njerëz që kanë punuar 30-40 vjet me ditat në dorë e tash me i shqiptua masë disiplinore - pensionim të parakohshëm, nëse dëshiron me shkua, është bazë neni 32.6, mësimdhënësi ka të drejtë të kërkojë pensionim të parakohshëm, me 70 % të pagës bazë, duke filluar nga mosha 60 vjeç.

Nëse e analizoni me i shqiptuar masa disiplinore njeriut në moshën 60 vjeçare, gati para pensionit të rregullt, është keq dhe nuk besoj që është e ligjshme.

Fatos Dibra u përgjigj, duke thënë se në shërbimin civil është e ligjshme.

Agim Gashi theksoi se dihet që pushimet mjekësore më shumë se 20 ditë gjatë vitit nuk paguhen. Nëse ato nuk paguhen, vetë gjendja shëndetësore dhe rregullativa ligjore e detyron personin me pranua ofertën për pension të parakohshëm, është fjala për sëmundje të rënda. Unë mendoj formulimi te neni 32,6 duhet të jetë i tillë, që të sëmurin e obligon me pranuar ofertën e jo me ia shqiptua masën disiplinore. Neni 67 ia shqipton masën disiplinore, e ndëshkon, e neni 32.6 ia ofron mundësinë obligative, sepse ti rrinë në shtëpi por nuk paguhesh.

Fadil Gashi nuk u pajtua me parafolësit, duke thënë se ke arsimtar që 40 vjet ka kontribuar dhe në fund përfundon në komision disiplinor, kjo nuk është në rregull.

Shpresa Shala shprehu mendimin se duhet gjetur një mënyrë që me ia dhënë këtë mundësi, sepse është emergjente, situata është alarmante.

Eman Rrahmani, lidhur me dy nenet, 67.11 dhe 32.6, tha se pajtohem plotësisht me zotëri Halimin, se neni 67.11 duhet të hiqet, për shkak se është i panevojshme dhe tendencioz, andaj mbështetjen e Grupit tonë nuk ka me pasur në Kuvend, ndërsa neni 32.6 e zgjidh këtë problem.

Vala Peshku shprehu mendimin se për shkak të mungesës së Ligjit të sigurimeve shëndetësore, duhen dispozita të tilla, edhe unë po e kuptoj që dëshira e vetme është me e zgjidhur një nyjë që qenka lidhur për këta persona. Esenca këtu është me e gjetur një zgjidhje, se këto krejt kanë për të rënë në ujë në momentin që miratohet Ligji i sigurimeve shëndetësore.

Osman Bllaca dha sqarime, duke cekur se prej moshës 60 vjeçare për me qitur në komision disiplinor, e kemi paraparë për shkak të disa mësimdhënësve. Ne i kemi lutur një, dy, tre mësimdhënës, iu kemi thënë nuk se nuk jeni për me dalë para nxënësve, po ju dërgojmë në bibliotekë apo ndonjë pozitë tjetër ku kemi mundësi, nuk pranojnë dhe nuk shkojnë, kemi shumë raste të tilla.

Eman Rrahmani tha se këtë mundësi nuk e ke pasur me ia ofruar 70% të pagës dhe ajo nuk ta cakton moshën, që do me thënë është mbi 60 vjeç dhe nuk ta zgjidh problemin mosha, se ata persona janë më të rinj se 60 vjeç.

Agim Gashi tha se mund të shtohet një fjali te neni 67.11, një fjali që do të ketë sado pak kuptim humanitar, që do të thoshim për raste ekstreme dhe jo disiplinimin si masë e fundit që shkon në pension, ndërsa neni 32 me rregullua shkuarjen në pension si rezultat i gjendjes së rëndë shëndetësore. Kjo është e drejtë, këtë ne po e kërkojmë.

Agim Kuleta, kryesues, tha se ne i kemi dy situata këtu, e para është për një person që nuk është i aftë me ushtruar atë detyrë, është i vetëdijshëm për atë punë dhe kërkon vullnetarisht me gjetur zgjidhje, dhe situata e dytë, kur është i paaftë me kryer atë punë dhe nuk është i vetëdijshëm ose nuk donë me pranuar me lëshuar atë pozicion. Tash është efekti i dëmshëm për shoqërinë, nxënësit dhe të tjerët, d.m.th të drejtat dhe obligimet e stafit drejtues i kemi aty, çka duhet me qenë nivel profesional, me reflektuar bashkëpunim, me reflektua profesionalizëm, gjithë këto që janë, dhe struktura e ligjit është e tillë që kur i parasheh të drejtat dhe obligimet, parasheh masat nëse nuk kryhen ato obligime. Pasi që strukturat e ligjit janë të tilla të ngurta, e ka sjellë punën që me hy te masat disiplinore, se nuk ka ku me hy tjetër, mirëpo ne mundemi me gjetur formulimin adekuatë për këtë çështje.

Fatos Dibra dha sqarime lidhur me këtë çështje. Ai tha se mundemi edhe me hequr si nen komplet, nëse mendohet se zgjidhja është vetëm me këtë.

Eman Rrahmani propozoi që te neni 32.6 të jetë mundësia prej 55vjeç me kërkuar pension të parakohshëm vullnetarisht me 70% të pagës, duke filluar nga mosha 55 vjeçe, këtu sidomos te arsimi, në mënyrë që me u hapur dera edhe kuadrove të reja, në mënyrë që të shtohet cilësia në arsim.

Agim Gashi theksoi se ne nuk mund t'i klasifikojmë të një fushe, por institucioni e ka detyrë me u krijuar kushtet ligjore edhe atyre që i godet sëmundja dhe ne po iu krijojmë kushte, se neni 32.6 dhe neni tjetër po u krijon kushte që ata me u trajtuar në mënyrë njerëzore, nuk mundesh me ia dhënë pagën e plotë, sepse ai nuk shkon në punë, dhe si masë reale është propozimi 70%, varësisht nga mundësit buxhetore.

Agim Kuleta, kryesues, the se ideja është që neni 67,11 të hiqet krejt, në mënyrën që mësimdhënësi me qenë para situatës që ose me kërkuar vullnetarisht pension të parakohshëm, ose me pushua nga puna, ky është propozimi.

Eman Rrahmani, neni 67.11 do të kishte pasur kuptim sikur mos të kishte pasur të kufizuar moshën dhe që ishin përfshirë njerëz të cilët për shkak të sëmundjeve të rënda nuk mundë t'i

arrijnë punët për të cilat janë të ngarkuar, atëherë kishte pasur kuptim çfarëdo moshe, ose me i caktuar sëmundjet e caktuara nga të cilat kanë të drejtë të kërkojnë pension të parakohshëm me 70% të pagesës, siç është sëmundja e kancerit, sëmundjet psikike etj., por në këtë pjesë duhet me qenë edhe përvoja e punës, p.sh. me pasur 10 vjet përvojë pune ka të drejtë me kërkuar pensionim të parakohshëm.

Osman Bilaca tha se kemi lloj-lloj rastesh që paraqiten, drejtor, sekretar etj., që me pyesin si me vepruar me këtë rast. Ne kemi tentuar, qëllimi ynë ka qenë me bërë diçka në këtë drejtim, sa e kemi shfrytëzuar kapacitetin tonë, dijen tonë prej rasteve të ndryshme dhe kemi këto dy propozime.

Agim Gashi, propozimi te neni 67, nëse personat nuk e respektojnë, nuk sillen konform nenit 32.6 e bart në nenin 67, e kjo atëherë e humanizon rregulloren, d.m.th. e ke fjalën për një përqindje kokëkrisur që nuk e respekton, dhe e thua te 67, personat që nuk sillen konform nenit 32,6 i nënshtrohen masës disiplinore.

Agim Kuleta, kryesues, tha sponsori i Rregullores i morri parasysht vërejtjet, inkorporohen këto dhe sillen në Kuvend.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimrregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për organizimin e punës në shkolla fillore të mesme të ulëta dhe të mesme të larta, 01. nr. 031-142411, dt. 09.06.2016 dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e katërt

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Alban (Sulejman) Ramadanit.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Alban (Sulejman) Ramadanit dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e pestë

Propozimvendimi për plotësim – ndryshimin e Vendimit nr. 01.463/01-0101088/19, dt.

03.05.2019, për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi private.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për plotësim – ndryshimin e Vendimit nr. 01.463/01-0101088/19, dt. 03.05.2019, për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi private dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e gjashtë



Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim Ndërmarrjes Publike Banesore (NPB).

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim Ndërmarrjes Publike Banesore (NPB) dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e shtatë

Propozimvendimi për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm për zonën "Mati 1", vazhdimi i rrugës "B" (Bahri Fazliu), pjesa jugore, 2019-2027.

Genc Bashota tha se kjo ka kaluar dy herë në Kuvend dhe tash ka dalë në diskutim publik, u krye diskutimi publik e tash është vetëm çështja e votimit për miratim të Planit, i ka kaluar të gjitha procedurat.

Eman Rrahmani ashtu si çdo herë, për këtë pikë unë ngre shqetësimin për Hartën zonale dhe Planin zhvillimor, që gjatë këtij muaji është dashur të miratohen dhe me përfunduar si dy dokumentet më të rëndësishme për Prishtinën.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm për zonën "Mati 1", vazhdimi i rrugës "B" (Bahri Fazliu), pjesa jugore, 2019-2027, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e tetë

Propozimvendimi për miratimin e Vendimit për lënien në dispozicion të projektdokumentit të Planit rregullues të hollësishëm për zonën e lagjes "Kalabria", pjesa e kolektorit.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për miratimin e Vendimit për lënien në dispozicion të projektdokumentit të Planit rregullues të hollësishëm për zonën e lagjes "Kalabria", pjesa e kolektorit, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e nëntë

Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ngritjen e shtatores së senatorit amerikan Robert Doll.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ngritjen e shtatores së senatorit amerikan Robert Doll dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

Procesmbajtësja
Shyhrete Islami

Kryesuesi i Komitetit
Agim Kuleta

Faqe 10 nga 10

